

**Special Prosecution Office
Prokuroria Speciale
Kancelarija Specijalnog Tužilaštva**



**LIBËRTH STATISTIKOR
deri më 27 qershor 2011**

Hyrje

Gjatë periudhës kohore Korrik 2010 – Qershor 2011, PSRK ka dhënë kontributin e saj në luftën kundër krimit të organizuar, rasteve të korrupsionit të profilit të lartë dhe krimeve të luftës. Më një zyrë që përbëhej nga 11 Prokurorë ndërkombëtarë, 10 Prokurorë vendorë dhe 60 pjesëtarë të stafit mbështetës (ligjor dhe jo-ligjor), dukë përfshirë edhe pesë ekspertët e financave për Task Forcën Anti-Korrupsion, që ju bashkëngjitën stafit të PSRK-së në Prill 2011, PSRK-ja ka përballuar në mënyrë efektive sfidat e saj që ishin një kombinim i rasteve të trashëguara nga UNMIK-u dhe veprimtarive kriminale të ndodhura në vijim.

Ky libërth është krijuar për të nënvizuar në mënyrë statistikore këtë punë hetimore dhe prokuroriale në funksion të transparencës dhe llogaridhënies.

Gjatë vitit të shkuar janë bërë përpjekje të mëdha veçanërisht në tre drejtime.

Së pari, rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit kanë tërhequr një vëmendje të madhe nga mediat vendore dhe ndërkombëtare, si dhe nga bashkësia ndërkombëtare më gjerësisht. Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë, PSRK-ja, me bashkëpunimin e plotë të Policisë së Kosovës dhe Policisë së EULEX-t, ka ndërmarrë mbi 28 veprimtari operacionale para-gjyqësore duke përfshirë kontrollat dhe arrestimet. Kjo përfshin edhe dy operacione me një arrestim të një të pandehuri në Veri.

Përveç drejtimit para-gjyqësor, këtë vit, PSRK ka depozituar aktakuza në një numër rastesh penale të profilit të lartë, duke përfshirë këtu rastin “Medicus”; rastin e “Doganës dhe akcizave të duhanit”, dhe rastin “PTK.

Pas konfirmimit të aktakuzave, është rritur edhe shpeshtësia dhe kohëzgjatja e seancave gjyqësore, duke pasqyruar kështu kompleksitetin e provave në zotërim të prokurorisë. Në fakt, në rastin e kohëve të fundit të Bankës Kreditore të Prishtinës, prokurorët e PSRK-së kanë shpenzuar mbi 50 ditë në seanca gjyqësore.

Së dyti, një vëmendje e veçantë nga PSRK-ja i është kushtuar edhe krimeve të luftës. Shembujt e kësaj vëmendjeje të përqëndruar në to mund të gjenden në fillimin e hetimit për krime luftë mbi “Masakrën e Mejës”, që ka ndodhur më 27 dhe 28 Prill 1999, në Mejë dhe Orize të Komunës së Gjakovës. Kjo ngjarje, përpara EULEX-t, nuk ishte hetuar asnjëherë. ” Në “rastin Cahani” veprat penale kishin ndodhur gjatë konfliktit në Shqipërinë veriore.

Drejtimi i tretë dhe i fundit i vëmendjes së PSRK-së ka qenë në lidhje me dosjet penale që EULEX-i trashëgoi nga UNMIK-u. Nga një sasi prej 179 hetimesh të hapura, 111 tashmë janë përmbyllur.

Më tej, është me rëndësi të vërejmë se PSRK-ja ka adoptuar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve nën sferën e saj të përgjegjësisë. Kjo ka përfshirë qënien në ballë të bashkëpunimit teknik me Serbinë në ndjekjen e krimeve të luftës si p.sh “Çyshku” dhe krimit të organizuar si p.sh rasti “Tisa”, në mënyrë që kryerësit e tyre të dilnin para drejtësisë, pavarësisht nga

kombësia e tyre. Në një etapë të mëvonshme, kjo ka sjellë si rezultat dënimin e merituar që të pandehurit kryesorë kanë marrë si pjesë e një rrjeti për kontrabandimin e migrantëve.

Në të njëjtën mënyrë, bashkëpunimi efektiv me shtetet anëtarë të Bashkimit Europian ka qenë me mjaft rëndësi për ecurinë e hetimeve të rasteve komplekse. Për shembull, bashkëpunimi ndërmjet PSRK-së dhe homologëve tanë prokurorë në Slloveni, Itali dhe Gjermani në rastin “Fortuna”, që kishte të bënte me një grup kriminal me shtrirje të gjërë, solli deri tek ngritja e aktakuzës dhe gjykimi ndaj tre personave për veprën e krimit të organizuar dhe trafikimit të drogës. Pritet që gjatë muajit në vijim të shqiptohet edhe aktgjykimi. Megjithatë, ende ekziston nevoja për të forcuar bashkëpunimin me vendet anëtarë të Bashkimit Europian për të pasur sukses në rastet që ende mbeten për tu zgjidhur.

Ka pasur një sukses të prekshëm nga ana e Prokurorëve të Kosovës në kuadër të PSRK-së gjatë periudhës për të cilën po raportojmë, gjë që pasqyron tendencën për tju ngarkuar Prokurorëve të Kosovës më shumë raste të profilit të lartë. Kjo arritje është veçanërisht e dukshme në luftën ndaj krimit të organizuar, krimit financiar dhe rasteve të krimeve të luftës, disa prej të cilave janë dorëzuar vetëm gjatë kohëve të fundit.

Në fakt, ky kalim i suksesshëm i përgjegjësisë tek prokurorët e Kosovës gjen pasqyrim edhe në konfirmimin e një aktakuze më datë 14 Prill 2011, nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në rastin Novo Bërdo/Artanë. Ky ishte rasti i parë që u hetua dhe u udhëhoq tërësisht nga një Prokuror i Kosovës.

Hapa shumë të rëndësishëm janë bërë dhe me rastet e krimit të organizuar që janë marrë nën përgjegjësi nga Prokurorët kosovarë të PSRK-së. Kjo përfshin rastin e lumit Tisa dhe vrasjen e Triumf Rizës, për të cilët janë shqiptuar tashmë aktgjykimet. Përveç kësaj, kohët e fundit, në Prill 2011, u konfirmua në tërësi nga Gjykata, një aktakuzë lidhur me rrëmbimin e një biznesmeni në Pejë në Shtator 2010.

I ashtuquajturi rasti i “Bankës Qëndrore” gjithashtu është ndjekur nga një Prokuror i Kosovës me mbështetjen e plotë të prokurorëve të PSRK-së së EULEX-it.

PSRK njih nevojën për të demonstruar përkushtimin dhe kontributin që ajo ka dhënë për të ndërtuar dhe zhvilluar një proces efektiv të mbizotërimit të të drejtës në Kosovë si dhe kërcënimin që krijon për shoqërinë, si ekonomikisht ashtu edhe politikisht, mungesa e një sistemi të tillë.

Rastet e profilit të lartë, të cilat tashmë kanë arritur në fazën e gjyqimit, janë një dëshmi e këtij përkushtimi. Megjithatë, ne gjithashtu jemi të ndërgjegjshëm se ende mbeten shumë sfida për tu përballuar si në drejtim të hetimeve të tanishme dhe atyre që do të ndërmerren në të ardhmen ashtu edhe në përgatitjen e transferimit të funksioneve ekzekutive nga EULEX-i tek autoritetet e Kosovës.

Prishtinë, 28 Qershor 2011

Isabelle Arnal & *Sevdije Morina*
Kryeprokurore e PSRK *Zv-Kryeprokurore e PSRK*

PËRMBAJTJA

I – PËRMBLEDHJE E OPERACIONEVE DHE ARRESTIMEVE KRYESORE NGA KORRIKU 2010 DERI MË 28 QERSHOR 2011

II – STATISTIKAT

A – Rastet e PSRK-së deri më 15 qershor 2011

B – Krimet e ndërlidhura me korrupsion në PSRK

C – Autorizimi i njësiteve hetimore për rastet e korrupsionit në PSRK

D – Gjykimet në vijim në PSRK deri më 15 qershor 2011

E – Caktimi i rasteve Prokurorëve të PSRK-së

F) – Paraburgimi dhe masat tjera alternative për rastet e PSRK-së në qershor 2011

III – RASTET E MBETURA TË UNMIK-ut

IV- NË NIVEL TË AKTAKUZËS, GJYKIMEVE DHE VENDIMEVE

I- PËRMBLEDHJE E OPERACIONEVE DHE ARRESTIMEVE KRYESORE NGA KORRIKU 2010 DERI MË 27 QERSHOR 2011


Nga korriku 2010 deri tani ka pasur një numër të konsiderueshëm të veprimtarisë së dukshme operacionale, përfshirë mbi njëzet e tetë (28) kontrolle/arrestime në hetime të ndërlikuara.

- 1) Ministria e Shëndetësisë (korrik 2010) – Policia e EULEX-it - Korrupsion;
- 2) Banka Qendrore e Kosovës, (korrik 2010) – Policia e Kosovës nga Task Forca Anti Korrupsion e PSRK-së – Krime Financiare;
- 3) PTK (korrik 2010)- Policia e EULEX-it – Krime Financiare dhe Korrupsion;
- 4) Disa kontrolle/bastisje ndodhën në hetimet Bllaca për Krim të Organizuar dhe Krime luftime (gusht 2010) – Policia e EULEX-it;
- 5) Rasti i MPTP-së (gusht 2010)- Policia e EULEX-it – Krime Financiare dhe Korrupsion;
- 6) Skenderaj (shtator 2010) - PK nga Task Forca Anti Korrupsion (PSRK) – Krime Financiare;
- 7) Arrestim – rasti Dardania - (shtator 2010) PK nga Task Forca Anti Korrupsion (PSRK)
- 8) 26 nëntor 2010 – Kosova e Re (Prishtinë) – Policia e Kosovës nga Task Forca Anti Korrupsion e PSRK-së – Krime Financiare;
- 9) Rahovec – Policia e EULEX-it – Krimet e Luftës;
- 10) Shtabi i përgjithshëm i Doganave. Rasti i Duhanit dhe Akcizës (dhjetor 2010) – Policia e EULEX-it – Krime Financiare;
- 11) Rasti Fortuna (4 dhjetor 2010) – Policia e Kosovës – Krim i organizuar dhe trafikim droge;
- 12) Arrestimi i profilit të lartë kriminal në Pejë (dhjetor 2010) – Policia e Kosovës (PK) – Krim i Organizuar
- 13) Rasti MPTP (janar 2011) – Policia e EULEX-it – Krim Financiar dhe Korrupsion;
- 14) Operacioni i 15 shkurtit 2011 përfshinte kontrollet në mëngjesin e hershëm të pesë (5) lokacioneve në Zubin Potok shkurt 2011- Policia e EULEX-it – Krim i Organizuar;
- 15) Operacioni lidhur me rastin e BKT-së – 28 shkurt – Policia e Kosovës nga Task Forca Anti Korrupsion e PSRK-së
- 16) Kontrolli në Pejë - Policia e Kosovës nga Task Forca Anti Korrupsion e PSRK-së (30 mars 2011) – Krim Financiar;
- 17) Arrestimi i të pandehurve në Malishevë dhe Lipjan në mars dhe prill 2011 – Policia e EULEX-it – Krime luftime;
- 18) Arrestimi i një të pandehuri në Pejë (maj 2011) – Arrestimi nga Policia e EULEX-it – Trafikimi me Drogë;
- 19) Operacioni për arrestimin e një të pandehuri në rastin Veriu (maj 2011) – Policia e EULEX-it – Krim i Organizuar;
- 20) Arrestimi i pesë të pandehurve lidhur me kontrabandimin e migrantëve (Prizren) maj 2011- Policia e Kosovës – Krim i organizuar dhe trafikimi me njerëz;
- 21) Arrestimi i gjashtë Oficerëve të PK-së në Mitrovicën Veriore dhe Jugore (maj 2011) - Task Forca Anti Korrupsion (PSRK) – Krim i Organizuar dhe Korrupsion;
- 22) Gjykata Komunale e Lipjanit –(maj 2011) – Policia e Kosovës - Vepra të Korrupsionit;
- 23) Arrestimi i tre të dyshuarve (vrasje e trefishtë) –(30 maj 2011) – Policia e Kosovës;
- 24) Arrestimi i shtatë të pandehurve lidhur me kontrabandimin e migrantëve – (10 dhe 13 qershor 2011) – Policia e Kosovës – Krim i Organizuar dhe trafikimi me njerëz; dhe
- 25) Kontrollet në kontekst të pastrimit të parave dhe shmangies së tatimit (14 qershor 2011) – Policia e Kosovës.
- 26) Kontrollet – Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit – hetim i përbashkët i EULEX-it /PK-së korrupsion (15 qershor 2011)
- 27) Kontrollet në kontekst të qasje e paligjshme në informacione të kredit karteleve më 17 qershor 2011. Policia e Kosovës


Kontrollet në Zyrën Kadastrale të Komunës së Graçanicës – Raste të korrupsionit – Policia e EULEX-it

A) Rastet e PSRK-së deri më 15 qershor 2011

Aktualisht, PSRK ka 253 raste nën hetim. Kjo përfshin të gjitha fushat nën kompetencën e saj, përfshirë Krimet e Luftës, Terrorizmin, Krimin e Organizuar dhe Financiar. Ndarja e të gjitha rasteve nën secilën kategori është e paraqitur më poshtë:




Krimet e ndërlidhura me Korrupsionin në Dosjen e PSRK-së




C) Autorizimi i njësive hetimore për rastet e korrupsionit në PSRK

Autorizimi i njësive hetimore për rastet e korrupsionit deri më 22 qershor 2011



D) Gjykimet në vijim në PSRK deri më 15 qershor 2011




E) Caktimi i rasteve Prokurorëve të PSRK-së

Caktimi i rasteve Prokurorëve të PSRK-së

Prokurorët e Kosovës

92
36%




Prokurorët
e Eulex-it

161
64%


E) Paraburgimi dhe masat e tjera alternative për rastet e PSRK-së në Qershor 2011

Paraburgimi dhe masat e tjera alternative në Qershor 2011




III- Rastet e mbetura të UNMIK-ut

**Prej 179 rasteve të UNMIK-ut
111 raste ishin përfunduar nga PSRK
deri më 15 qershor 2011**



68 RASTE TË MBETURA TË UNMIK-ut DERI MË 16 qershor 2011



IV - NË SHKALLËN E AKTAKUZËS, GJYKIMEVE DHE VENDIMEVE

- 1) Gjithsejtë, në mes Janarit dhe Qershorit 2011 së paku pesëmbëdhjetë **15 Raste të Krimi të Organizuar** kanë arritur në shkallën e aktakuzës, gjykimit ose vendimit.
- 2) Sa i përket Krimin Financiar, tri (3) aktakuza të profilit të lartë janë ngritur dhe konfirmuar gjatë kësaj periudhe. Kjo përfshin ngritjen e aktakuzave në rastet **PTK dhe Akcizës së Duhanit** në Qershor 2011. **Tri (3) aktakuza tjera për krime financiare pritet të ngritën së shpejti.**

GJYKIM¹

Janë dhjetë (10) raste të PSRK-së në gjykim e sipër deri më 15 qershor 2011 përfshirë gjykimin e Cahanit për krime të luftës të Sabit Gecit dhe Riza Alija, gjykimin e Fahredin Gashit etj. PPS 09/2010 (në të cilin Bllaca është dëshmitar bashkëpunues).

¹ Në 2009, katërmbëdhjetë (14) gjykime janë përfunduar nga PSRK-ja. Në 2010 dhjetë (10), gjykime janë përfunduar nga PSRK-ja.
Statistikat e PSRK-së
28 qershor 2011

3) **VENDIME**

Janë dhjetë (10) **vendime** gjatë periudhës kohore (Janar – 20 qershor 2011) në vepra të krimit financiar dhe të organizuar në veçanti gjykimi “**Lumi Tisa**” që ka të bëjë me krim të organizuar dhe kontrabandim të njerëzve nga Kosova përmes Serbisë në Unionin Evropian. Një vendim për rastin e trafikimit të drogës “**Rasti Fortuna**” i cili ka lidhje me vendet e Unionit Evropian pritet në Korrik 2011.